



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.1997/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit N..., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson avokati Veton Raci, kundër të paditurit M... Sh.p.k., të cilin e përfaqëson D.M. , me objekt kontesti anulim kontrate dhe kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 20.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit N..., me numër KE.nr.1997/22 (EK.nr.12/22), me objekt kontesti anulim kontrate dhe kompensim dëmi, kundër të paditurit M... Sh.p.k., të cilin e përfaqëson D.M. .

A r s y e t i m

Paditësi N..., përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 11.01.2022, ka parashtruar padi për anulim kontrate dhe kompensim dëmi, ndaj të paditurit M... Sh.p.k.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit N..., me datën 14.01.2022, me anë të parashtrësës, e ka njoftuar gjykatën se tërheq padinë për lëndën KE.nr.1997/22 (EK.nr.12/22), të datës 11.01.2022, kundër të paditurit M... Sh.p.k., për shkak se palët sipas kontratës e kanë paraparë që zgjidhjen e kontratës ta bëjnë përmes Arbitrazhit në Oden Ekonomike të Kosovës, andaj paditësi e tërheq padinë për këtë çështje juridike.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, në kuptim të nenit 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KE.nr. 1997/22, datë 20.09.2022.

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.